



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 1325/23
Kaçanik, 17.01.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja I (parë) e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 17 janar 2023 (e Martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka.
Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e I-të (parë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, data 17 janar, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbali ?

Procesverbali i mbledhjes së X-të (dhjetë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2022, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së X-të (dhjetë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2022, të datës 20.12.2022 / Lënda : 01Nr. 60/01-33129/22.

2. Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023;

z.Ekrem Livoreka: Hapi diskutimin lidhur me planin e punës së Komitetit për komunitete, nëse keni ndonjë propozim.

z.Arben Thaqi: Duke pasur parasysh që gjendja e pandemisë është përmisuar, propozojë që pika lidhur me situatën e pandemisë Covid-19, të largohet nga plani i punës së Komitetit për Komunitete dhe të futet një pikë tjetër konkretisht „Gjendja aktuale e QKMF-së”.

Strategjia e përmbushjes së planit të mbetet në planin e punës mirëpo aktivitetet duhet të ndryshohen. Propozojë që tek pika e 6-të tek e cila përfshihen aktivitetet rinore të përfshihen si pikë edhe aktivitet sportive, ndërsa tek pika e 7-të e këtij plani propozojë që të hy në plan si pikë „Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut”.

z.Betim Shala: Pajtohem me propozimet e z.Arben Thaqit.

z.Ekrem Livoreka: Pajtohem me propozimet e bëra nga z.Arben Thaqit, lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e aktiviteteve në planin e punës së Komitetit për Komunitete, specifikisht përfshirjen e pikave si „Gjendja aktuale QKMF-së në Kaçanik” dhe „Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut”.

znj.Arta Avdiu: Pajtohem me propozimet që u cekën më lartë nga z. Arben Thaqit.

znj.Lejla Muhaxheri-Çaka: Gjithashtu edhe unë pajtohem me propozimet e z.Arben Thaqit.

z.Ekrem Livoreka: Vazhdojmë sipas radhës me pikët e planit të punës së Komitetit për Komunitete.

Në pikën 1 të planit „Gjendja aktuale e QKMF-së në komunën e Kaçanikut”, të hy si aktivitet vizita me drejtorin e QKMF-së, me qëllim që të informohemi rreth furnizimit me barna esenciale si dhe procesin e vaksinimit .

z.Ekrem Livoreka: Pika 2-të Strategjia e përmbushjes së planit të Komitetit për Komunitete.

z.Arben Thaqi: Lidhur me pikën e 2-të në planin e punës së Komitetit për Komunitete duhet të ketë strategji mirëpo aktivitetet duhet të ndryshohen. Në këtë pikë propozojë të hy si aktivitet: „Organizimi i një tryeze me qytetarë” dhe „Trajnim me anëtarët e Komitetit për Komunitete”.

z.Ekrem Livoreka: Pika 3-të , „Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut - mbetet në plan të punës.

Pika 4-të, „Të drejtat e qytetarëve të komunës së Kaçanikut - mbetet në plan të punës.
Pika 5, „Ndarja e garantëve dhe subvencioneve për OJQ - mbetet në plan të punës.

z.Arben Thaqi: Tek pika e 6-të, „Aktivitete rinore dhe sportive komunën e Kaçanikut”, të hy si aktivitet „Raporti i klubeve sportive dhe në pikën 7-të, „Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut”.

z.Ekrem Livoreka: Pika 8-të, “Rastet sociale në komunën e Kaçanikut” - mbetet në plan të punës.

Pika 9-të, “Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut” - mbetet në plan të punës .

z.Ekrem Livoreka: Pika 10-të, “Krijimi i hapësirave për parkingje”, kjo pike mendojë se duhet të largohet nga ky plan dhe të futet një pikë tjetër “OVL- UÇK-së në komunën e Kaçanikut” dhe si aktivitet në këtë pikë të hy takimi me OVL e UÇK-së dhe takimi me familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës.

A jeni të pajtimit që ky plan i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023, ti përcillet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim?

Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023 , u shtrua në votim dhe i njëjti u votua njëzëri. Me këtë konstatojmë që:

Plani i Punës së Komitetit për Komunitete, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3.Të ndryshme:

z.Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 13:40.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

